



Banka e Shqipërisë

METODOLOGJI*

PËR


“SHTESËN KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT NË SHQIPËRI”

* Kjo Metodologji publikohet në zbatim të rregullore “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, miratuar me vendimin nr.41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (më tej ‘rregullorja 41/2019’).



P Ë R M B A J T J A


AKRONIME	4
FJALORTH	5
PËRMBLEDHJE	6
1. HYRJE	8
2. ÇFARË ËSHTË "SHTESA KUNDËRCIKLIKE E KAPITALIT"?	9
2.1 Përcaktimi dhe llogaritja e shtesës kundërciklike të kapitalit	9
2.2 Parimi i reciprocitetit	10
3. BANKA E SHQIPËRISË DHE ROLI I SAJ NË ZBATIMIN E SHTESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT	12
4. KUADRI ANALITIK I SHTESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT NË SHQIPËRI	13
4.1 Treguesi parësor: "Hendeku i raportit kredi për ekonominë ndaj PBB-së"	13
4.2 Kalibrimi i vlerave të treguesit parësor	14
4.3 Treguesi i paralajmërimit të hershëm plotësues	15
4.4 Konsiderimi i treguesve të tjerë	15
4.5 Çlirimi i shtesës kundërciklike të kapitalit	16
4.6 Llogaritja dhe publikimi i shtesës kundërciklike të kapitalit	17
5. KOMUNIKIMI I SHTESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT	18
6. PËRFUNDIME	18
SHTOJCË I	19
SHTOJCË II	21
i. Metodologjia e ndërtimit të treguesit të paralajmërimit të hershëm plotësues	21
ii. Treguesi plotësues dhe ndërlidhja me normën e shtesës kundërciklike të kapitalit	22



AKRONIME

BSh	Banka e Shqipërisë
GKSF	Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar
KKSF	Komiteti Këshillimor i Stabilitetit Financiar
DSF	Departamenti i Stabilitetit Financiar
KUNC*¹	Shtesa Kundërciklike e Kapitalit (normë në %)
AKUNC*	KUNC i aplikuar
SPEKUNC*	KUNC specifik për bankën
KONS*	Shtesa Konservuese e Kapitalit (normë në %)
KMP	Kredi me probleme
KBNI*	Kapitali Bazë i Nivelit të Parë
BERRS*	Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik
BE	Bashkimi Evropian
KBMB	Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare
MPM	Mekanizmi i Përbashkët Mbikëqyrës
DKK	Direktiva për Kërkesat për Kapital
RrKK	Rregullorja për Kërkesat për Kapital
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
TPHP	Treguesi i Paralajmërimit të Hershëm Plotësues
EPR*	Ekspozimet e ponderuara me Rrezik
EPSHK*	Ekspozim i Përshtatshëm Krediti
Filtri HP	Filtri Hodrick-Prescott

¹ (*) – Përkufizimet e plota të termave jepen në rregulloren "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", miratuar me vendimin nr.41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.



FJALORTH

Termtat: KBN1; KUNC; AKUNC; SPEKUNC; KONS; Pagesë shpërndarjeje, Juridiksion i huaj; Autoriteti përgjegjës i huaj; EPR; EPSHK – kanë të njëjtin kuptim si në rregulloren 41/2019.

Kredia për ekonominë – Përfaqëson tepricën e kredisë ndaj sektorit privat jofinanciar (individët dhe korporatat). Pra, nuk përfshin huamarrësit jorezidentë, por përfshin të gjitha burimet e financimit të huamarrësve privatë rezidentë.

Hendeku i raportit të kredisë ndaj PBB-së – diferenca midis nivelit aktual të raportit të kredisë ndaj PBB-së dhe prirjes afatgjatë të saj. Ky tregues pasqyron zhvillimet e aktivitetit kreditues në lidhje me PBB-në e vendit. Kur raporti tejkalon prirjen afatgjatë të treguesit, kreditimi i sektorit privat është duke u rritur më shpejt se PBB-ja e vendit, duke nënkuptuar që kreditimi i ri nuk kontribuon mjaftueshëm për rritjen e PBB-së.

KMP – kreditë me probleme janë kreditë ku vlerësohet që kredimarrësi nuk ka aftësi të plotë paguese, ose ku kredimarrësi gjendet me mbi 90 ditë vonesë nga data e pagesës së këstit të kredisë. Shuma e tyre bruto (principal + interes) jep totalin e kredive me probleme.

RKP – është raporti i kredive me probleme (RKP) dhe nënkupton totalin e kredive me probleme ndaj tepricës të kredisë, i shprehur në përqindje.

Filtri HP – Filtri Hodrick-Prescott është një mjet standard statistikor i përdorur në ekonomi për të përcaktuar prirjen historike të një ndryshoreje me kalimin e kohës. Një filtër rekursiv ose njëkahësh nënkupton që vetëm informacioni i disponueshëm në secilën pikë të kohës përdoret për llogaritjen e prirjes historike. Parametri sheshues përcakton ndjeshmërinë e prirjes historike ndaj luhatjeve afatshkurtra në të dhënat statistikore.

TREGUES REFERENCË – nënkuptojnë treguesin parësor dhe atë plotësues, të cilët do të përdoren nga ana e Bankës së Shqipërisë në kuadër të përcaktimit të KUNC.



PËRMBLEDHJE

Banka e Shqipërisë publikon këtë metodologji për zbatimin e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC), për bankat që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Kjo metodologji shoqëron rregulloren 41/2019 dhe mbështetet në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr.38, datë 2.8.2017 (më tej 'Strategjia').


Shtesa kundërciklike e kapitalit është një instrument i ri në zbatim të politikës makroprudenciale, vlerat e të cilës mund të ndryshojnë përgjatë ciklit financiar. Kjo shtesë mbahet në instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë (KBN1) dhe llogaritet mbi ekspozimet e përshtatshme të kreditit (EPSHK) të secilës bankë. Zbatimi i KUNC, kryhet në përputhje me parashikimet në DKK dhe udhëzimet e BERRS. Sipas standardeve evropiane, KUNC-i është një nga "shtesat makroprudenciale të kapitalit", ku përfshihen edhe: a) shtesa konservuese e kapitalit; b) shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike; dhe c) shtesa e kapitalit për rrezikun sistematik. Të gjitha këto shtesa synojnë të nxisin rritjen e rezistencës së sektorit bankar, me qëllim përbalimin e situatave që mund të përbëjnë rrezik për stabilitetin financiar.

Si rregull, KUNC-i përfiton vlera nga 0% - 2.5% të totalit të ekspozimeve të peshuara me rrezik, por mund të jetë edhe më i lartë në rastet kur rreziqet të cilat lidhen me rritjen e tepërt të kredisë ose rreziqet e tjera sistemike, vlerësohen si shumë të larta. Gjatë periudhës së akumulimit të rrezikut sistematik, Banka e Shqipërisë mund të aplikojë shtesën KUNC, e cila përgjatë fazës rënëse të ciklit financiar, mund të çlirohet. Kështu, gjatë fazës së rritjes së shpejtë, bankat duhet të krijojnë rezerva të mjaftueshme kapitali, të cilat do të mund të përdoren gjatë fazës rënëse të ciklit për të përthithur humbjet e mundshme në bilanc në mënyrë që oferta e kredisë në ekonomi të mos pakësohet apo ndërpritet.

Metodologjia paraqet kuadrin e përgjithshëm analitik për caktimin e një norme të përshtatshme të KUNC-it.

Kuadri i mësipërm përbëhet nga dy tregues: një tregues parësor, i mirëpërcaktuar (rule-based) dhe që ruhet në kohë² dhe, një tregues të dytë – plotësues – natyra e të cilit është "fleksibël", çka nënkupton mundësinë e shtimit apo zëvendësimit të nëntreguesve përbërës të tij, në rast nevojë. Tregues parësor, në rastin e Shqipërisë, do të jetë "hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së". Ky tregues dëshmon deri në çfarë mase kredia rritet


² Kjo nënkupton që elementet përbërëse të tij janë të pandryshueshme në kohë, jo nga pikëpamja e vlerave që përftojnë por nga pikëpamja e pazëvendësueshmërisë së tyre.



më shpejt se aktiviteti ekonomik, krahasuar me prirjen e tij afatgjatë. Një hendek i madh pozitiv mund të jetë një tregues i zgjerimit të tepërt të kredisë.

Ndërsa, treguesi plotësues do të shërbejë si orientues për vendosjen e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit në periudhat kur treguesi parësor nuk është në gjendje të ofrojë sinjalet e duhura për vënien në zbatim apo çlirimin e shtesës kundërciklike. Ky tregues, krahas atij parësor, përfshin vlerësimin e një sërë nëntreguesish të tjerë që lidhen me rritjen e tepërt të kredisë dhe të rrezikut sistematik. Në çdo rast, vlerat që merren nga treguesit, janë subjekt i analizës më të plotë të ekspertëve.

Metodologjia është strukturuar si vijon: kapitujt 1 dhe 2 paraqesin bazat konceptuale të kuadrit të përgjithshëm analitik të KUNC-it, mbështetur në praktikën ndërkombëtare. Kapitulli 3 shpjegon mënyrën se si KUNC-i do të përcaktohet për Shqipërinë. Kapitulli 4 shpjegon procesin e vendimmarrjes dhe kapitulli 5 përmban përfundimet kryesore. Përveç kësaj, dokumenti përfshin edhe dy shtojca, të cilat shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së treguesit parësor dhe të atij plotësues.



1. HYRJE

Kriza financiare botërore e vitit 2008 shfaqti mangësitë në zbatimin e politikave ekonomike dhe financiare, duke përfshirë mungesën e një kuadri makroprudencial. Kriza evidentoi se autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemit financiar përgjithësisht nuk kishin mandate të përshtatshme ligjore, mjetet analitike dhe/ose instrumentet e duhura për të adresuar në kohë rrezikun sistematik. Në një këndvështrim të tillë, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (KBMB) hartoi një kuadër të ri të njohur si Bazel III, që përfshinte rekomandimet për cilësi më të mirë dhe sasi më të lartë kapitali, me qëllim rritjen e rezistencës së sektorit bankar ndaj rreziqeve sistemike me natyrë ciklike e strukturore, si dhe kufizimin e ndikimit të tyre në ekonominë reale.

Në Bashkimin Evropian, këto rekomandime u kthyen në kërkesa ligjore përmes adoptimit të Direktivës për Kërkesat e Kapitalit dhe Rregullores me të njëjtin emër, në fund të vitit 2014.



2. ÇFARË ËSHTË "SHTESA KUNDËRCIKLIKE E KAPITALIT"?

Shtesa kundërciklike e kapitalit është një instrument i politikës makroprudenciale, që adreson natyrën ciklike të rrezikut sistemik të lidhur me huadhënien e tepërt. Ajo është një nga shtesat makroprudenciale të kapitalit, ku të tjerat janë: shtesa konservuese e kapitalit, shtesa e kapitalit për bankat me rëndësi sistemike dhe shtesa e kapitalit për rrezikun sistemik strukturor.

Si rregull, shtesa kundërciklike e kapitalit përfton vlera 0% – 2.5% të ekspozimeve të peshuara me rrezik të bankës, por mund të jetë edhe më e lartë në rastet kur rreziqet të cilat lidhen me rritjen e tepërt të kredisë, vlerësohen si shumë të larta. Kjo shtesë rritet gjatë fazës rritëse të ciklit ekonomik/financiar dhe mund të ulet, për të përthithur humbjet në bilancin e bankave, gjatë fazës rënëse të ciklit.

Çdo bankë e llogarit shtesën specifike kundërciklike të kapitalit, mbështetur në ekspozimet e përshtatshme të kreditit që ajo ka dhe në normën e shtesës kundërciklike të kapitalit që ka shpallur autoriteti përgjegjës nën juridiksionin e të cilit banka i ka ekspozimet. Për Shqipërinë, ky autoritet është Banka e Shqipërisë.

2.1 PËRCAKTIMI DHE LLOGARITJA E SHTESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Përdorimi i treguesve sasiorë për të mbështetur vendimmarrjen dhe informuar mbi normën e shtesës kundërciklike të kapitalit është një element i rëndësishëm i kuadrit mbi shtesën kundërciklike të kapitalit. Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (KBMB) rekomandon përdorimin e "hendekut të raportit të kredisë ndaj PBB-së" si tregues parësor, i cili shërben si udhëzues për përcaktimin e normës në fjalë. KBMB ka vëzhguar dhe testuar në mënyrë empirike se përgjatë kohërave dhe për një numër të konsiderueshëm vendesh, të zhvilluara dhe në zhvillim, ky tregues kishte qenë një paralajmërues i dobishëm i rritjes së rrezikut sistemik.

Megjithëse analiza empirike e kryer nga Komiteti i Bazelit dëshmon se "hendeku i raportit të kredisë ndaj PBB-së" është treguesi më i mirë për aktivizimin e normës së shtesës kundërciklike në shumë vende, ai ka edhe kufizimet e veta. Ndaj sugjerohet që autoriteti përgjegjës duhet të mbështetet edhe në një gamë më të gjerë treguesish, informacionesh dhe analizash, si elemente plotësuese në vendimmarrje. Këta të fundit përfshijnë tregues kyç të stabilitetit financiar, siç janë: treguesit e tregut të pasurive të paluajtshme apo



tregues të borxhit të sektorit privat. Gjithashtu, mund të merren në konsideratë edhe informacione shtesë, sasiore dhe cilësore, të përftuara nga mbikëqyrja bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës. Ky proces, i cili kombinon përdorimin e treguesve sasiore të bazuar në rregulla të mirëpërcaktuara (*rule based*), me një analizë më gjithëpërfshirëse të treguesve financiarë shtesë që bazohen në gjykimin ekspert, pajis vendimmarrësit me fleksibilitetin e nevojshëm në përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit, dhe njihet ndryshe si "gjykim i informuar" (*guided discretion*).

Baza e të dhënave të treguesve të përzgjedhur për caktimin e normës së shtesës kundërciklike është fleksibël prej natyre ndaj dhe mund të rishikohet vazhdimisht, në mënyrë që treguesit të mund të shtohen dhe/ose përshtaten me kalimin e kohës, me qëllim pasqyrimin e plotë të rreziqeve sistemike kryesore.

Zbatimi i parimit të "gjykitimit të informuar" në momentin e vendimmarrjes është i rëndësishëm sepse, në rrethana të caktuara, tregues të ndryshëm mund të ofrojnë sinjale të ndryshme apo edhe kundërshtuese. Kundërshtitë midis treguesve mund të ketë më shumë gjasa të shfaqen gjatë fazës së çlirimit të normës, kur treguesit më pak dinamikë (tipikisht treguesi parësor), evidentojnë nevojën për zbatimin e një norme shtesë, ndërsa treguesit më dinamikë (si p.sh., ata që bazohen në tregje), evidentojnë një periudhë stresi financiar dhe nevojën për çlirim apo zvogëlimin e normës në fjalë. Megjithatë, në një moment kohor të caktuar, treguesit mund të sugjerojnë sinjale më të forta ose më të dobëta mbi rritjen e nivelit të rrezikut. Ndaj, politikëbërësit do të duhet të vlerësojnë maksimalisht treguesit individualë dhe përshtatshmërinë e tyre në kontekstin e një vlerësimi më të gjerë të mjedisit makrofinanciar. Vendimmarrja duhet të jetë proporcionale me nivelin e rrezikut dhe duhet të marrë parasysh qëndrimin e përgjithshëm të politikës makroprudenciale në atë kohë. Si rezultat, norma e shtesës kundërciklike të kapitalit që sugjerohet nga treguesit sasiore, nuk është domosdoshmërisht ajo që miratohet nga vendimmarrësit.

2.2 PARIMI I RECIPROCITETIT

Siç përcaktohet në standardet e KBMB-së, reciprociteti në vendosjen e KUNC-it është i nevojshëm për të siguruar që zbatimi i tij në një shtet të caktuar nuk shtrembëron rregullat e një "loje të barabartë" mes bankave vendase dhe atyre të huaja, të cilat kreditojnë, drejtpërsëdrejti, sektorin privat në atë juridiksion.

Si rregull, autoriteti i vendit (juridiksionit) pritës do të marrë rolin udhëheqës në përcaktimin e kërkesave për normën e shtesës kundërciklike të kapitalit që do të përlllogaritet mbi ekspozimet e përshtatshme të kreditit të mbajtura nga bankat që ushtrojnë aktivitet në juridiksionin e tyre. Autoriteti pritës pritet të informojë homologët e tij të huaj mbi kërkesat për normën e shtesës kundërciklike, në mënyrë që këto të fundit të mund t'u kërkojnë bankave të tyre t'i respektojnë këto kërkesa. Autoritetet vendase do të jenë përgjegjëse për të siguruar që bankat




të llogarisin në mënyrë të saktë normën, bazuar në vendndodhjen gjeografike të ekspozimeve të tyre.

Autoritetet vendase gëzojnë të drejtën t'u kërkojnë bankave që mbikëqyrin, të mbajnë norma më të larta nëse gjykojnë se normat e autoriteteve pritëse janë të pamjaftueshme. Megjithatë, autoritetet vendase nuk duhet të zbatojnë një normë më të ulët mbi ekspozimet e kreditit të bankave të tyre ndaj shtetit pritës, në mënyrë që të mos krijojnë një disavantazh konkurrues ndaj bankave vendase të atij shteti. Nga ana tjetër, në rastet kur bankat kanë ekspozime në shtete që nuk zbatojnë apo nuk publikojnë normën e shtesës kundërciklike të kapitalit, autoritetet vendase mund të vendosin në mënyrë të njëanshme normën e shtesës kundërciklike për ekspozimet ndaj shteteve të lartpërmendura.

Ashtu si për kërkesat për kapital minimal dhe shtesën konservuese të tij, autoritetet pritëse kanë të drejtën të kërkojnë që shtesa kundërciklike të mbahet në nivel individual dhe/ose të konsoliduar brenda juridiksionit të tyre.

Brenda BE-së, reciprociteti në zbatimin e shtesës kundërciklike të kapitalit (anëtare ose jo të KBMB-së) është i vetvetishëm dhe i detyrueshëm deri në një normë prej 2.5% të ekspozimeve të peshuara me rrezik. Reciprociteti për normën mbi nivelin prej 2.5% mbetet në diskrecionin e shteteve individuale të BE-së. Anëtarëve të BE-së iu kërkohet gjithashtu të njohin normat e «shteteve të treta» (të përcaktuara si shtete jashtë zonës ekonomike evropiane) pavarësisht nga anëtarësia e tyre në KBMK për normat deri në 2.5%. Jashtë BE-së, praktikat e reciprocitetit të shteteve janë të ndryshme.



3. BANKA E SHQIPËRISË DHE ROLI I SAJ NË ZBATIMIN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian ka përcaktuar një autoritet përgjegjës për hartimin e politikës makroprudenciale, pra edhe për vendosjen e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit.


Në Shqipëri, kuadri ligjor³ përcakton Bankën e Shqipërisë si bankë qendrore, e cila në të njëjtën kohë zbaton politikën monetare, vepron si autoritet rregullator, licencues, mbikëqyrës si edhe zgjidhës për bankat që veprojnë në Shqipëri, promovon funksionimin e sistemeve të pagesave dhe vendos rregulla për parandalimin dhe zbutjen e rrezikut sistemik⁴. Gjithashtu, në Ligj⁵ parashihet pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), fokusi kryesor i të cilit është parandalimi dhe zbutja e rrezikut sistemik në sistemin financiar. Për këtë të fundit, sektori bankar ka një rëndësi thelbësore. Bazuar në funksionet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe në rëndësinë e sektorit bankar në mbarëvajtjen e sistemit financiar, Banka e Shqipërisë është autoriteti parësor për të ushtruar politikën makroprudenciale në vend.

Banka e Shqipërisë do të përcaktojë normën e shtesës kundërciklike të kapitalit, të zbatueshme mbi ekspozimet e përshtatshme të kreditit të bankave në Shqipëri, dhe do ta shpallë atë në faqen e saj zyrtare të internetit. Njoftimi do të përfshijë gjithashtu edhe analizën mbështetëse që shoqëron vendimmarrjen në fjalë.

³ Funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë përcaktohen nga Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (Ligji organik); Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (Ligji për bankat); dhe ligji nr. 133/2016, datë 22.12.2016 "Për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave në Republikën e Shqipërisë".

⁴ Ligji për bankat, neni 66/1.

⁵ Ligji nr.9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, neni 30.



4. KUADRI ANALITIK I SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT NË SHQIPËRI

Për përcaktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit, Banka e Shqipërisë do të bazohet në dy tregues referencë, njëri parësor dhe tjetri plotësues. Treguesi parësor do të jetë "hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së" dhe tregon deri në çfarë mase kredia rritet më shpejt se prodhimi ekonomik vendas, krahasuar me prirjen e saj afatgjatë. Një hendek i madh pozitiv mund të sinjalizojë një zgjerim të tepruar të kredisë.

Treguesi plotësues do të përdoret për të udhëzuar në përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit në periudhat kur treguesi parësor nuk është në gjendje të ofrojë sinjale apo informacione të mjaftueshme për aktivizimin e normës në fjalë. Ky tregues, krahas atij parësor, përfshin vlerësimin e një sërë nëntreguesish të tjerë të rritjes së tepërt të kredisë dhe të rrezikut sistematik që shoqëron këtë të fundit dhe, njëkohësisht, përfshin edhe një element të rëndësishëm: "gjykimin ekspert". Edhe pse treguesi i mirëpërcaktuar është thelbësor për përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike, kuadri analitik bazohet në parimin e "gjykimit të informuar" dhe rezulton nga një vlerësim i përgjithshëm i rreziqeve sistematike, përfshirë analizën e një numri treguesish mbështetës.

4.1 TREGUESI PARËSOR: "HENDEKU I RAPORTIT KREDI PËR EKONOMINË NDAJ PBB-SË"

Zgjedhja e këtij treguesi, bazohet në përparësitë e mëposhtme:

- Hendeku i raportit të kredisë ndaj PBB-së njihet ndërkombëtarisht si një nga treguesit më të mirë të paralajmërimit të hershëm, si në tregjet e zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim;
- Ky tregues përputhet plotësisht me udhëzimet dhe metodologjinë e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (BERRS)⁶;
- Rezultatet analitike kanë treguar se treguesi do të kishte funksionuar mirë në të shkuarën edhe në rastin e Shqipërisë. Për shembull, të dhënat dëshmojnë se zgjerimi i "hendekut të raportit të kredisë ndaj PBB-së" paraprin rritjen e raportit të kredive me probleme me një periudhë prej gati 8 tremujorësh.

⁶ Për më shumë informacion, shiko Shtojcën I: "Qasje e standardizuar për llogaritjen e hendekut të raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së dhe metodologjia mbi shtesën kundërciklike të kapitalit".



Treguesi i mësipërm llogaritet si diferencë midis nivelit aktual të raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së dhe nivelit të vlerësuar të prirjes afatgjatë të tij. Për këtë qëllim, kredia përkufizohet si baza e gjerë e stokut të brendshëm të kredisë ndaj sektorit privat jofinanciar (familjet dhe korporatat jofinanciare). Raporti i kredisë ndaj PBB-së llogaritet më pas si teprica e kredisë e shprehur në përqindje të shumës së 4-tremujorëve të PBB-së nominale. Niveli i prirjes së raportit kredi ndaj PBB-së është llogaritur duke përdorur atë që njihet si filtri rekursiv Hodrick-Prescott (HP)⁷.

Vlerat e hendekut të këtij raporti do të përlogariten mbi baza tremujore, dhe për këtë Banka e Shqipërisë do të bazohet në përkufizimet e mëposhtme:

- Për "kreditë", do të përdorë të dhënat e "kredisë për ekonominë", të publikuara në seksionin statistikor të faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë. Kjo përfshin kreditë e dhënë për rezidentët në sektorin privat, nga bankat dhe institucionet financiare jobankare që operojnë në Shqipëri;
- Për "PBB-në", shifrën nominale të shpallur nga INSTAT-i dhe të publikuar në faqen e tij të internetit.

4.2 KALIBRIMI I VLERAVE TË TREGUESIT PARËSOR

Banka e Shqipërisë ka kryer analiza të shumta dhe të detajuara teknike për të provuar përshtatshmërinë e hendekut të raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së si një tregues i akumulimit të rrezikut sistemik që shoqëron rritjen e tepërt të kredisë dhe si orientues në përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit.


Bazuar në rezultatet e këtyre analizave dhe përvojën ndërkombëtare në zbatimin e normës së shtesës kundërciklike, Banka e Shqipërisë vlerëson të përshtatshme të përcaktojë si prag të poshtëm orientues - për caktimin e KUNC-it - devijimin me të paktën 2 pikë përqindje të raportit të kredisë ndaj PBB-së ndaj prirjes afatgjatë të tij. Pragu i sipërm është vendosur në 10 pikë përqindje.

Si rregull, norma e shtesës kundërciklike të kapitalit, do të orientohet si në vijim:

- 0 për qind, kur hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së është më i vogël se pragu i poshtëm prej 2 pikë përqindjeje;
- 2.5 për qind⁸, kur hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së është më i madh se pragu i sipërm prej 10 pikë përqindjeje;

⁷ Filtri HP është një mjet statistikor standard që përdoret në ekonomi për të përcaktuar prirjen e një ndryshoreje me kalimin e kohës. Një filtër rekursiv ose i njëanshem, nënkupton që vetëm informacioni i disponueshëm në secilën pikë të kohës përdoret për llogaritjen e prirjes. Një parametër zbutës përcakton ndjeshmërinë e prirjes për luhatjet afatshkurtra në të dhëna. Parametri zbutës i përdorur në këtë rast është 400,000 duke reflektuar prirjen afatgjatë në raportin e kredisë ndaj PBB-së.

⁸ Ose më i madh, nëse vlerësohet.



- (iii) do të rritet me një shumëfish të plotë të 0.25 për qind, për çdo rritje në vlerat e hendekut në intervalin 2-10 pikë përqindjeje. Në praktikë, kjo do të mundësojë që norma e shtesës kundërciklike të rritet edhe në mënyrë lineare midis 0 dhe 2.5 për qind, kur "hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së" rritet gradualisht përgjatë intervalit 2-10 pikë përqindjeje. Por zbatimi në mënyrë lineare i shtesës së kapitalit kundërciklik, në përputhje me ndryshimet në treguesin parësor, nuk është detyrues nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se zhvillimet në rrezik kërkojnë një qasje jolineare.

Më shumë detaje mbi përcaktimin e "hendekut të raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së" dhe ndërlidhjes së tij me normën e shtesës kundërciklike të kapitalit paraqiten në Shtojcën 1.

4.3 TREGUESI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PLOTËSUES


Analizat teknike të kryera nga Banka e Shqipërisë sugjerojnë se ndërkohë që hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së do të funksiononte në kohë normale, ai mund të mos jetë i aftë të sinjalizojë një periudhë rritjeje të tepruar të kredisë pas një periudhe të tejzgjatur të karakterizuar nga një ritëm i ulët rritjeje të kredisë.

Ndaj, Banka e Shqipërisë ka ndërtuar një tregues të përbërë të rrezikut sistemik, të quajtur "treguesi i paralajmërimit të hershëm plotësues" për të identifikuar më shpejt zhvillimet që sinjalizojnë rritje të rrezikut sistemik ciklik. Treguesi plotësues përfshin, krahas treguesit parësor, disa nëntregues të tjerë individualë të përzgjedhur. Këta nëntregues i referohen kryesisht variablave të bazuar në kredi dhe në tregun e pasurive të paluajtshme. Një rritje e ndjeshme e çmimeve të pasurive të paluajtshme shpesh shoqërohet me rritje të përshejtuara të kredisë për pasuri të paluajtshme, sidomos nëse kombinohet me standarde të "relaksuara" kreditimi.

Për këtë qëllim është ndërtuar një databazë e plotë e cila fillon që prej T4-2003 dhe përditësohet mbi baza tremujore. Vlerat e treguesit plotësues ndërlidhen gjithashtu me vlerat e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit, njësoj si në rastin e treguesit parësor. Më shumë detaje rreth këtij treguesi paraqiten në Shtojcën 2.

4.4 KONSIDERIMI I TREGUESVE TË TJERË

Disa tregues dëshmojnë një korrelacion më të fortë, por vetitë e tyre sinjalizuese mund të jenë të ndryshme gjatë periudhës/ave të rritjes ose zvogëlimit të normës së shtesës kundërciklike të kapitalit.



Në fakt, gjatë periudhave të stresit financiar, shumë nga treguesit e përdorur gjatë fazës së akumulimit të rrezikut sistematik, përfshirë "hendekun e raportit të kredisë ndaj PBB-së", mund të mos jenë më të përshtatshëm, nisur nga disponueshmëria në kohë e të dhënave dhe natyra e tyre më pak dinamike. Të dobishme në këto raste mund të rezultojnë analizat mbi borxhin e sektorit privat apo informacionet që mund të përftohen nga mbikëqyrja bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës.


Në nivel ndërkombëtar, puna për ndërtimin dhe përdorimin e treguesve sinjalizues gjatë fazës së çlirimit të normës së shtesës kundërciklike nuk ka përparuar aq shumë sa në rastin e vendosjes së saj. Megjithatë, në përgjithësi, çmimet e aktiveve jofinanciare në tregje së bashku me treguesit e likuiditetit në to, që reagojnë më shpejt ndaj zhvillimeve financiare, konsiderohen të jenë të volitshme.

Në përgjithësi, Banka e Shqipërisë do të përdorë treguesin parësor, atë plotësues dhe tregues të tjerë të nevojshëm për të mbështetur analizën e saj dhe për të ndihmuar në kalibrimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit përgjatë kohës.

4.5 ÇLIRIMI I SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Banka e Shqipërisë do të konsiderojë çlirimin e shtesës kundërciklike të kapitalit kur sektori bankar regjistron humbje në bilanc, të tilla që të përbëjnë rrezik për stabilitetin financiar në vend ose kur zhvillime jo të favorshme në sistemin financiar mund të zvogëlojnë apo ndërpresin kreditimin e ekonomisë, duke dëmtuar ecurinë e ekonomisë reale dhe gjeneruar humbje shtesë për sektorin.

Bazuar në përvojën e paketë ndërkombëtare në kuadër të çlirimit të KUNC-it, nuk është e lehtë të përcaktohen rregulla të qarta për çlirimin e kësaj shtese në rastin e Shqipërisë. Mjafton të përmendet se, ndërkohë që BSh-ja vendos për çlirimin e shtesës dhe përcaktimin e masës apo ritmit të çlirimit, ajo do të duhej të merrte parasysh të dhënat mbi: stresin e përgjithshëm sistematik që rezultojnë në gjëryerjen e nivelit të kapitalit të bankave; indeksin e materializimit të rrezikut të sektorit bankar; nivelin e kredive me probleme; humbjet e pësuar nga bankat; mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave; masën në të cilën rritja e kredisë kufizohet nga niveli i kapitalit; çmimet e banesave dhe të pasurive të paluajtshme tregtare; si edhe çdo faktor tjetër që konsiderohet i rëndësishëm për vendimmarrjen.



4.6 LLOGARITJA DHE PUBLIKIMI I SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Shtesa kundërciklike e kapitalit do të zbatohet për të gjitha bankat, por në nivel banke, ndikimi i saj është i ndryshëm, në varësi të madhësisë dhe përbërjes së ekspozimeve të përshtatshme të kreditit. Banka ka detyrimin të identifikojë në mënyrë të saktë llojin dhe juridiksionin e ekspozimeve të përshtatshme të kreditit. Në tërësi, mënyra e llogaritjes së kësaj shtese kapitali, roli i Bankës së Shqipërisë dhe i vetë bankës, mënyra e raportimit të saj dhe mënyra e ndryshimit të shtesës kundërciklike të kapitalit, do të bëhet në përputhje me rregulloren 41/2019, posaçërisht me nenet 11, 12 dhe 13 të saj.

Veçojmë që, shtesa kundërciklike e kapitalit do të mbahet me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë. Në rastin e rritjes së saj, banka duhet të përmbushë kërkesën brenda një periudhe jo më të gjatë se 12 muaj nga data e shpalljes së Bankës së Shqipërisë, ndërsa në rastin e uljes së saj, çlirimi i kapitalit të bankës mund të kryhet edhe menjëherë pas shpalljes së Bankës së Shqipërisë.

Nëse Banka e Shqipërisë vlerëson se regjimi i shtesës kundërciklike të kapitalit cenohet nga fakti që kredia në ekonomi kanalizohet nëpërmjet institucioneve financiare jobanka dhe rritja e kredisë është e tillë që tejkalon pragun limit referues, do të vlerësohet nevoja për zbatimin e masave rregullatore që mundësojnë zbatimin e kërkesave për kapital kundërciklik edhe ndaj subjekteve të tilla, nëse ato janë subjekt licencimi dhe mbikëqyrjeje nga BSh-ja. Në të kundërt, BSh-ja do të informojë autoritetin mbikëqyrës përgjegjës për t'i nxitur këto të fundit të aplikojnë kërkesën rregullatore me efekt të ngjashëm kundërciklik.



5. KOMUNIKIMI I SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Banka e Shqipërisë, çdo tremujor, do të shpallë normën KUNC dhe do ta publikojë atë në faqen zyrtare të internetit së bashku me informacionin shpjegues të vendimmarrjes. Për këtë, Banka e Shqipërisë do të përcaktojë normën e shtesës kundërciklike të kapitalit (përfshirë nivelin 0%), duke marrë parasysh vlerën e treguesit parësor, vlerën e treguesit të paralajmërimit të hershëm plotësues, si edhe tregues të tjerë të rëndësishëm, nëse e vlerëson të nevojshme për adresimin e rrezikut sistemik.

Njoftimi tremujor do të përfshijë gjithashtu një informacion në lidhje me kohën e aplikimit.

Mënyra e vendimmarrjes dhe e shpalljes së shtesës kundërciklike të kapitalit, përcaktohet në rregulloren 41/2019, posaçërisht në nenet 15 dhe 16 të saj.

6. PËRFUNDIME

Shtesa kundërciklike e kapitalit është një instrument i rëndësishëm makroprudencial, i cili më vete ose i ndërthurur me instrumente të tjera makroprudenciale, ndihmon në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe zbut luhatshmërinë në ciklin financiar.

Për të vendosur normën KUNC, Banka e Shqipërisë do të përdorë një sërë treguesish sasiorë dhe cilësorë, dhe do ta shpjegojë publikisht vendimin e saj përfundimtar bazuar në parimin e gjykimit të informuar. Tregues të tillë do të rishikohen rregullisht dhe do të përdoren në mënyrë fleksibël.

Për arsye se shtesa kundërciklike e kapitalit është një instrument i ri i politikës makroprudenciale, kuadri analitik i përshkruar në këtë metodologji do të rishikohet dhe përditësohet sipas nevojës.



SHTOJCË I

LLOGARITJA E TREGUESIT "HENDEKU I KREDISË NDAJ PBB-SË" DHE LIDHJA ME MADHËSINË E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Hendeku i kredisë ndaj PBB-së llogaritet si diferencë midis nivelit aktual të raportit të kredisë ndaj PBB-së dhe nivelit të vlerësuar të prirjes së tij afatgjatë. Në këtë mënyrë, hendeku matet në pikë përqindjeje të PBB-së. Rekomandimi i BERS/2014/1 përshkruan një qasje të standardizuar për të llogaritur hendekun e kredisë, duke siguruar një referencë të përbashkët për të gjitha vendet në përcaktimin e normës KUNC.

Sipas qasjes së standardizuar, kredia përkufizohet si një matës i gjerë i tepicës së kredisë për sektorin privat jofinanciar (individët dhe korporatat jofinanciare). Më tej, raporti i kredisë ndaj PBB-së llogaritet si përqindje e tepicës së kredisë ndaj PBB-së nominale të vjetorizuar. Prirja afatgjatë e këtij raporti llogaritet duke përdorur atë që njihet si një filtër rekursiv Hodrick-Prescott (HP)⁹.

Më pas aplikohen nivelet e pragut në hendekun e kredisë ndaj PBB-së në mënyrë që të llogaritet një normë përkatëse shtesë. Në këtë rast, përdoret një prag i poshtëm prej 2 pikë përqindjeje dhe një prag i sipërm prej 10 pikë përqindjeje. Shtesa përkatëse kundërciklike në kapital është e barabartë me:

- 0 për qind, kur hendeku i kredisë është më i vogël se pragu i poshtëm prej 2 pikë përqindjeje;
- 2.5 për qind, kur hendeku i kredisë ndaj PBB-së është më i madh se pragu i sipërm prej 10 pikë përqindjeje;
- Një rritje lineare prej 0.25 për qind (ose një shumëfish i saj) përdoret për të ndryshuar masën e shtesës kundërciklike (midis 0 dhe 2.5 për qind), ndërkohë që "hendeku i kredisë ndaj PBB-së" rritet nga 2 në 10 pikë përqindjeje.

⁹ Filtri Hodrick-Prescott është një mjet standard statistikor i përdorur në ekonomi për të përcaktuar prirjen historike të një ndryshoreje me kalimin e kohës. Një filtër rekursiv ose njëkahësh nënkupton që përdoret vetëm informacioni i disponueshëm në secilën pikë të kohës për llogaritjen e prirjes historike. Parametri sheshues përcakton ndjeshmërinë e prirjes historike ndaj luhatjeve afatshkurtra në të dhëna. Parametri sheshues në këtë rast është 400,000, duke reflektuar prirjen afatgjatë të raportit të kredisë ndaj PBB-së.



Tabelë 1. Hendeku i raportit të kredisë ndaj PBB-së dhe lidhja me shtesën kundërciklike të kapitalit

Devijimi i raportit kredi ndaj PBB-së nga mesatarja afatgjatë (vjetore)	Shtesa përkatëse kundërciklike e kapitalit
Deri në 2%	0%
Midis 2% dhe 4%	0.5%
Midis 4% dhe 6%	1.0%
Midis 6% dhe 8%	1.5%
Midis 8% dhe 10%	2.0%
Mbi 10%	2.5% ose më shumë

Më tej, hapi tjetër është përcaktimi i agregatit të kredisë që do të përdoret. Për këtë, është zgjedhur "kredia për ekonominë", e cila, në linjë me rekomandimin e KBMB/BERS, përfshin kredinë e dhënë nga bankat dhe institucionet financiare jobankare për sektorin privat jofinanciar vendas (duke përjashtuar huamarrësit jorezidentë. Seria e të dhënave daton që prej tremujorit të katërt të vitit 2002.




SHTOJCË II

I. METODOLOGJIA E NDËRTIMIT TË TREGUESIT TË PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PLOTËSUES

Nëntreguesit që përbëjnë treguesin e paralajmërimit të hershëm plotësues (TPTH) përfshijnë:

Tabelë 1 - Përbërësit e TPHP

Treguesi	Objektivi	Përshkrimi
Hendeku i kredisë ndaj PBB-së	Të vlerësojë ndryshimin e rritjes së kredisë ndaj rritjes ekonomike, përshtatur me prirjen e saj afatgjatë.	Raporti Kredi ndaj PBB në periudhën t (Raporti $_t$) = $\text{Kredi}_t / \text{PBB}_t * 100\%$ <ul style="list-style-type: none"> PBB $_t$ është Prodhimi i Brendshëm Bruto; dhe, Kredia $_t$ është kredia për ekonominë, bazuar në përkufizimin e gjerë të kredisë ndaj sektorit jofinanciar privat rezident në periudhën t. Të dy treguesit, PBB-ja dhe kredia, janë në terma nominalë dhe kanë një frekuencë tremujore. Hendeku në periudhën $_t$; Hendeku $_t$ = Raporti $_t$ - Prirje afatgjatë në periudhën $_t$.
Intensiteti i kredisë	Të vlerësojë rritjen graduale të kredisë ndaj rritjes ekonomike, referuar periudhës së mëparshme dhe jo prirjes afatgjatë.	Ndryshimi vjetor i kredisë ndaj sektorit privat ndaj PBB-së kumulative të 4 tremujorëve të fundit, vlerësuar si një përafërues i mirë për kredinë e re në ekonomi.
Rritja e kredisë për prona të paluajtshme	Të vlerësojë rritjen e tepërt në kreditë hipotekare si një tregues i stresit sistematik.	Vlerëson ritmin e përsheptuar të rritjes së kredisë për prona të paluajtshme.
Rritja e Indeksit të çmimit të banesave ndaj qirasë	Të vlerësojë deri në ç'masë një rritje e tepërt e kredisë hipotekare mund të krijojë mbinxehje të çmimeve të banesave kundrejt atyre të qerasë.	Vlerëson mbinxehjen e mundshme të çmimit të pasurive të paluajtshme, zbutur për 8 tremujorë, kundrejt atyre të qerasë.
Rritja e Indeksit real të çmimit të banesave	Të vlerësojë rritjen e tepërt të çmimeve të banesave, rregulluar për inflacionin.	Kap zhvillimet në çmimet e aktiveve jofinanciare, përshtatur me inflacionin dhe zbutur për 8 tremujorë.
Rritja reale e kredisë	Të vlerësojë rritjen e tepërt të kredisë, por të papërshtatur për rritjen e PBB-së.	Vlerëson ritmin e përsheptuar të rritjes së kredisë, mbështetur vetëm në tepërcën e kredisë për sektorin privat jofinanciar rezident, rregulluar për kreditë e fshira dhe për inflacionin.



Metodologjia e përdorur për të agreguar informacionin e mbledhur nga treguesit e përzgjedhur në një indeks të vetëm plotësues është e njëjtë me atë të përdorur për ndërtimin e Indeksit të Rrezikut Sistemik Financiar¹⁰.

Fillimisht, të gjithë nëntreguesit organizohen në të njëjtën mënyrë, për të siguruar përdorimin dhe krahasueshmërinë e kësaj baze të dhënash. Për këtë, secili nga këta variabla kalon në një proces standardizimi, i cili transformon të dhëna të ndryshme në një format të përbashkët. Ky proces kryhet thjesht duke zbritur mesataren nga çdo e dhënë për secilën periudhë dhe më pas pjesëtohet me devijimin standard të serisë kohore. Pas përfundimit të këtij procesi për secilin nëntregues, treguesi përfundimtar agregohet nëpërmjet një mesatareje të thjeshtë të papeshuar të të gjithë variablave të standardizuara.

Së fundmi, TPHP përfundimtar përftohet nëpërmjet një përshkallëzimi nga 0 në 1 përmes një transformimi logaritmik. Ky proces siguron një komunikim më të mirë të këtij treguesi tek organet vendimmarrëse dhe më tej tek publiku, pasi kjo shkallë e caktuar e bën këtë tregues një mjet mjaft të lehtë për t'u interpretuar dhe për t'u krahasuar përgjatë kohës, ndërsa databaza pasurohet në kohë.

II. TREGUESI PLOTËSUES DHE NDËRLIDHJA ME NORMËN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

TPHP ndërtohet si një tregues i përbërë, i cili merr vlera midis 0 dhe 1. Duke u bazuar në vlerat e përcaktuara të pragut dhe duke konsideruar një shkallë gabimi në matje dhe në model, pragu i poshtëm mund të caktohet në nivelin 0.5. Duke ndjekur praktikën e bankave të tjera qendrore¹¹, të cilat gjithashtu mbështeten në përdorimin e treguesve të përbërë për të përcaktuar normën përkatëse të KUNC-it, ndërlidhja e mundshme e treguesit plotësues me normën e shtesës kundërciklike të kapitalit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 2 - TPHP dhe lidhja me normën e KUNC-it

Niveli i TPHP	Shtesa përkatëse kundërciklike e kapitalit
Deri në 0.5	0%
Midis 0.5 dhe 0.6	0.5%
Midis 0.6 dhe 0.7	1.0%
Midis 0.7 dhe 0.8	1.5%
Midis 0.8 dhe 0.9	2.0%
Midis 0.9 dhe 1	2.5% ose më shumë

¹⁰ https://www.bankofalbania.org/Botime/Nje_indeks_i_rrezikut_sistemik_financiar_per_Shqiperine.html

¹¹ Shih Bankën Qendrore të Çekisë dhe atë të Republikës së Slovaqisë lidhur me qasjen e tyre në përcaktimin e normës së KUNC-it.



